



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 273 Akti

Nr. 328 Vendimi
Tiranë, më 28.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 24.12.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Adriano Dymishi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 24.12.2020, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Adriano Dyrmishi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, pranë: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “*Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio*”. Në këto kushte ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.1.2019, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët: Lulzim Hamitaj, Alma Faskaj dhe Suela Zhegu.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi kishte administruar të tri raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 18.1.2019 kishte vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Suela Zhegu. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues kishin deklaruar se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi.
- v. Më pas, për arsye objektive, në bazë të vendimit nr. 18, datë 9.3.2020, të Komisionit, komisionere Alma Faskaj është zëvendësuar, nëpërmjet shortit të datës 10.4.2020, nga komisioniere Brunilda Bektoshi, e cila gjithashtu ka deklaruar mospasjen e ndonjë konflikti të interesave me subjektin e rivlerësimit. Ky zëvendësim i anëtarit të trupit gjykues i është njoftuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike dhe pasi është njohur me këtë ndryshim, z. Adriano Dyrmishi ka deklaruar mospasjen e ndonjë

konflikti interesi me anëtarën zëvendësuese, sikurse me anëtarët e tjerë të trupit gjykues.

- vi. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit, z. Adriano Dyrmishi, në datën 10.12.2020, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën e hetimit dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vii. Në datën 11.12.2020, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të paraqitur shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën – për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.
- viii. Pasi u njoh me dosjen, subjekti i rivlerësimit paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegimet e shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- ix. Në datën 21.12.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 24.12.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin e Komisionit, z. Adriano Dyrmishi ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, të cilat i kishte paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacion provues përkatës. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iii. Seanca dëgjimore e datës 24.12.2020 u mbyll, për të rifilluar më 28.12.2020 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii)

raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP); (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, së bashku me argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (viii) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, ka konsistuar në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/1. RIVLERËSIMI I KRITERIT TË PASURISË

1. Apartament banimi në përdorim, Rr. *, Tiranë**

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë si adresë banimi në DIPP-në e vitit 2016 dhe në vitin 2017, pasuri e llojit apartament me nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe ndërtimi 92 m², në pronësi të shtetasit F. D.¹. Në Deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri në përdorim pa shpërblim, për shkak të miqësisë familjare me pronarin, ndonëse nuk është depozituar ndonjë akt/kontratë i/e nënshkruar midis palëve, lidhur me përdorimin e këtij apartamenti pa kundërshpërblim.

¹ Në dosje rezulton e administruar DIPP-ja e vitit 2004 e deklaruesit F. D. (ish-subjekt i deklarimit në ILDKPKI me funksion doganier në Kapshticë), nga ku përshkruhet pasuria apartament banimi 2+1, Rr. “****”, Tiranë e Re, blerë në shumën 3,500,000 lekë. Ky shtetas, sipas deklarimit është larguar në SHBA në vitin 2011.

2. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e përshkruar në vijim:
- i. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 14.1.2005, lidhur ndërmjet shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasit F. D. në cilësinë e palës blerëse, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe totale 92 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në vlerën 3,500,000 lekë².
 - ii. ASHK Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019, ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, dhe personave të lidhur³ nuk figurojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme në Tiranë.
 - iii. ASHK Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2020, ka konfirmuar se apartamenti me sipërfaqe 92 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** (i përdorur nga subjekti) i është shitur nga pronarët F. dhe L. D. palës blerëse A. P. dhe M. S., me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2019, kundrejt çmimit 74,000 euro.
 - iv. OSHEE-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 3.10.2019, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, nuk rezulton të jetë abonent apo të ketë kontratë furnizimi energjie me këtë institucion⁴.
 - v. UKT-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 27.9.2019, ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, dhe personave të lidhur me të nuk rezulton asnjë kontratë e regjistruar në emër të tyre.
 - vi. Në vijim të kërkesës së Komisionit, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 5.5.2020⁵, ka përcjellë të gjitha deklaratat periodike të subjektit deklarues F. D., pasi ky i fundit ka ushtruar detyrën si doganier për periudhën 2003 – 2011 dhe, për rrjedhojë, ka qenë subjekt deklarues pranë këtij institucioni.
 - vii. ILDKPKI-ja, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 29.7.2020, në përgjigje të kërkesës së Komisionit⁶ për të vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor shoqërues të deklaratave të pasurisë së shtetasit F. D., ka paraqitur edhe procesverbalin e datës 21.12.2006, të mbajtur në prezencë të dy inspektorëve të lartë, ku z. F. D. është pyetur dhe ka shpjeguar mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në fjalë.

² Informacion i ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga ZQRPP-ja, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, pjesë e dokumentacionit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.

³ Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4 për të sqaruar vendbanimin aktual të prindërve të tij, si dhe pasuritë në përdorim/pronësi, në përgjigje të të cilit subjekti ka sqaruar se prindërit e tij nuk kanë pasuri të paluajtshme në pronësi apo në përdorim. Ata kanë pasur në pronësi një apartament në Poliçan, të cilin e kanë shitur me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.11.2018 dhe nga ky moment kanë vijuar të jetonin në këtë banesë, me qira. Nga nëntori i vitit 2019 ata kanë jetuar në banesën e marrë me qira nga ana e tij dhe aktualisht në banesën e motrës së tij.

⁴ OSHEE-ja ka konfirmuar se në emër të shtetasit N. D. rezulton e regjistruar kontrata e abonimit me nr. *** në Fier, si dhe në emër të shtetasit L. D., kontrata e faturimit me nr. *** në Durrës. Nga përgjigja e ardhur nga FSHU-ja (OSHEE Group) me anë të shkresës nr. *** prot., datë 30.7.2020 është dhënë informacion i detajuar mbi këtë kontratë, e cila rezulton të jetë hapur në maj të vitit 1998 është shtëpi banimi përdhese, si dhe kontrata rezulton debitore për periudhën 2007-2011 dhe se nuk faturohet më që prej muajit gusht 2011. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, lidhur me ekzistencën e ndonjë pasurie (banesë private) të prindërve të tij të ndodhur në Durrës, në përgjigje të të cilit ka bërë me dije se prindërit e tij nuk zotërojnë dhe nuk kanë zotëruar banesë private në Durrës.

⁵ Në përgjigje të kërkesës nr. *** prot., datë 28.4.2020, të Komisionit.

⁶ Nr. *** prot., datë 24.7.2020, drejtuar ILDKPKI-së.

1.2 Lidhur me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit dhe rrethanat përkatëse

3. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, të datës 9.9.2019 ka shpjeguar se: *“Nga muaji qershor 2011 dhe deri në muajin mars 2019⁷, kam banuar në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, Rr. ‘***’, pallati ‘***’, nr. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë. Para muajit qershor 2011, kam jetuar së bashku me familjen në një banesë me qira, me adresë: Njësia Administrative Nr. ***, Rr. ‘***’, pallatet ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë. Sqaroj se në këtë periudhë kam përdorur apartamentin e ndodhur në Rr. ‘***’, pallati ***, nr. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, me pronar F. D., mik i familjes, i cili prej datës 8.6.2011 gjendet emigrant në USA.”*
4. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2010, ka vënë në dispozicion informacionin nga Regjistri Elektronik i Noterëve (RNSH), nga ku është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij brenda kësaj periudhe kohore (vitet 2011 – 2019) kanë nënshkruar disa akte noteriale, konkretisht me shtetasin V. R., një kontratë qiraje në datën 20.2.2014 dhe një kontratë huapërdorje në datën 3.10.2016, përkatësisht, për një apartament të ndodhur në Rr. “***”, p. ***, Tiranë dhe një apartament të ndodhur në Rr. “***”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë me nr. pasurie ***.
5. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 28.4.2020 dhe pyetësorit nr. 3, datë 30.6.2020 i kërkoi subjektit të rivlerësimit të vinte në dispozicion aktet noteriale, të cilat rezultuan nga RNSH-ja, si dhe të informonte lidhur me marrëdhënien e mundshme familjare, shoqërore apo të çfarëdolloji me shtetasin V. R. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, vuri në dispozicioni aktet noteriale⁸, nga ku në kontratën e qirasë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2014, palët kishin rënë dakord për marrjen me qira të apartamentit me një afat 1-vjeçar (e cila referuar kontratës i ka filluar efektet nga data 1.2.2014) dhe kundrejt shumës 5,000 lekë/muaj. Ndërsa në kontratën e huapërdorjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.10.2016, palët kishin rënë dakord për dhënien në përdorim të një apartamenti subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij për një periudhë 5-vjeçare.
6. Pasi është pyetur nga Komisioni lidhur me marrëdhënien që ka pasur/ka me këta shtetas, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se marrëdhënia me shtetasin V. R. është vetëm shoqërore dhe janë njohur në rrethana rastësore⁹ dhe se të dyja kontratat në fjalë (ajo e qirasë dhe kontrata e dhënies në përdorim) janë nënshkruar në vijim të komunikimeve të z. F. D., pasi ai mendonte që të kthehej në Shqipëri. Pra, bëhet fjalë për masa paraprake të marra nga ana e tij, në rast se do të duhej të largohej nga apartamenti i shtetasit z. F. D., sipas planeve të komunikuar nga ky i fundit se do të

⁷ Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2018, dorëzuar në datën 21.3.2019, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka si adresë banimi: Rr. “***”, pallati “***”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë.

⁸ Kontrata e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.2.2019; kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2014; kontratë huapërdorje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.10.2016, si dhe kontratën e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.2.2019 me shtetasin A. M.

⁹ Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shtetasi V. R. ka pasur dhe ka një bar-kafe në lagjen ku banonte.

rikthehej në atë banesë – por që konkretisht kthimi i parashikuar të dyja herët është shtyrë dhe, për rrjedhojë, këto kontrata *de facto* nuk janë ekzekutuar asnjëherë¹⁰.

7. Subjekti i rivlerësimit ka informuar se: *“Me F. është bërë një marrëveshje miqsh që nëse nuk do të ambientehej në SHBA (pas kohës që i duhej për dokumentacionin) ose nëse atij do t’i lindnin mundësi punësimi në vendin tonë në vazhdim, do të kthehej dhe do të jetonte përsëri në banesën e tij duke më lajmëruar 1-2 muaj para që unë të sistemohesha në banesë tjetër. Si në vitin 2014, ashtu edhe në vitin 2016, F. ka dashur të vinte në Shqipëri pasi kishte mundësi të mira punësimi. Më ka lajmëruar për këtë fakt (që mund të vinte) dhe unë kam marrë masat për t’u sistemuar me familjen. Meqënëse ai nuk erdhi, më ka lajmëruar dhe, për rrjedhojë, të dyja këto kontrata nuk janë ekzekutuar nga palët.”*
8. Lidhur me përdorimin pa shpërblim të apartamentit¹¹ të shtetasit F. D.¹², subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, sqaroi se ky shtetas është mik i familjes, pasi kanë origjinë nga i njëjti vend dhe se para se të largohej në SHBA, ai dhe bashkëshortja e tij i kanë kërkuar që subjekti i rivlerësimit të kujdesej dhe të jetonte në shtëpinë e tij, pasi nuk donte ta jepte me qira, pasi kishte merak se i shkatërrohej nga dhënia me qira.
9. Nga shqyrtimi i informacionit të ardhur nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2020 rezulton se shtetasi F. D. ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti në DIPP-në e tij të vitit 2004, me vlerën 3,500,000 lekë, por nuk ka deklaruar në këtë DIPP burimin e krijimit të pasurisë në fjalë. Në DIPP-në e vitit 2003, z. F. D. ka deklaruar gjendje *cash* në Bankën e Kursimeve në vlerën 1,000,000 lekë, me burim nga të ardhurat nga emigracioni në Greqi për periudhën 1995 – 2000 dhe gjendje të dhënë në huadhënie shoqërisë “****” sh. a. (Mallakastër), shumë prej 2,500,000 lekësh, gjithashtu me burim nga emigracioni në Greqi për periudhën 1995 – 2000.
10. Gjithashtu, nëpërmjet përgjigjeve pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se i është drejtuar ILDKPKI-së, duke i kërkuar informacion lidhur me dokumentacionin ligjor të burimit të ligjshëm të të ardhurave të shtetasit F. D., dhe ky institucion me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020 ka informuar se ky dokumentacion nuk mund të vihet në dispozicion të tij për shkak të të dhënave konfidenciale dhe sensitive që përmban dhe se ky informacion mund të vihet në dispozicion vetëm të institucioneve kompetente.
11. Në vijim të sa më sipër, Komisioni iu drejtua ILDKPKI-së, duke i kërkuar që vinte në dispozicion dokumentacionin ligjor shoqërues të DIPP-ve të shtetasit F. D. Nga dokumentacioni në fjalë, i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI¹³, datë 21.12.2006¹⁴, pasi është pyetur mbi burimin e krijimit të pasurisë apartament të blerë në shumë 3,500,000 lekë, z. F. D. ka shpjeguar se

¹⁰ Lidhur me këto apartamente të shtetasit V. R., Komisioni iu drejtua FSHU-së (OSHEE Group) dhe UKT-së për të vënë në dispozicion kontratat e lidhura për këto apartamente, faturimet dhe pagesat e kryera për to. FSHU-ja, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 30.7.2020 ka informuar se pas verifikimeve në terren, kontratat me kod *** dhe *** iu përkasin dy shtetasve M. B. (në procesverbalin datë 9.7.2020 për kontratën e këtij shtetasi rezulton shënimi se në këtë objekt banojnë qiraxhinj) dhe V. Gj., ndodhet në adresën Rr. “S. D.” të lidhura në vitet 2016 dhe 2018. Ndërsa UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2020, ka informuar se nuk mund të japë informacionin e kërkuar për shkak të pamjaftueshmërisë së të dhënave.

¹¹ Apartamenti i ndodhur në njësinë administrative nr. ***, Rr. “****”, pallati ***, nr. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë.

¹² Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se z. F. D. ka emigruar në SHBA nga data 8.6.2011 dhe ka vendosur në dispozicion adresën e e-mail të këtij shtetasi: ***

¹³ Procesverbal i vënë në dispozicion me kthim përgjigjen e ILDKPKI-së me anë të shkresës nr. *** prot., datë 29.7.2020.

¹⁴ Procesverbal i mbajtur ndërmjet këtij të fundit dhe dy inspektorëve të lartë H. Z. dhe H. M..

apartamenti është blerë me burim krijimi shumë e kthyer nga huadhënia prej 2,500,000 lekësh nga shoqëria “****”, si dhe nga gjendja *cash* prej 1,000,000 lekësh e krijuar gjatë viteve në emigracion, por nuk rezulton të jetë paraqitur nga ana e tij ndonjë dokumentacion ligjor provues mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie.

12. Lidhur me vendbanimin aktual, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, se prej fillimit të marsit të vitit 2019¹⁵ dhe aktualisht, ai banon, së bashku me familjen, në adresën: Rr. “****” (***), pallati i ri “****” sh.p.k., apartament në pronësi të shtetasit A. M., me të cilin ka lidhur edhe një kontratë qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 27.2.2019¹⁶.
13. Lidhur me situatën faktike të përshkruar më sipër, mbi rrethanat që ndërthuren me pasurinë në fjalë dhe përfshirjen e subjektit në gëzimin e të drejtave mbi të, është konstatuar se nuk ka rezultuar ndonjë kontribut financiar i dhënë nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit *de quo*, në vitin 2005, nga shtetasi F. D.
14. Në konkluzion, lidhur me këtë pasuri duke konsideruar: (i) faktin që apartamenti në fjalë është blerë në vitin 2005; (ii) që subjekti i rivlerësimit ka nisur funksionin si prokuror në vitin 2010; (iii) që përdorimi i banesës së sipërpërmendur ka nisur prej vitit 2011, kur z. F. D. (pronari) është transferuar në SHBA; (iv) që subjekti nuk ka dhënë ndonjë kontribut financiar për blerjen e pasurisë në fjalë dhe nuk ka përfituar ndonjë të drejtë reale mbi këtë pasuri (veç përdorimit të përkohshëm, si më lart); (v) që ka rezultuar i deklaruar asokohe disponimi konkret dhe më i hershëm, nga z. F. D. i shumave të përdoruara për blerjen e kësaj pasurie (pjesërisht të depozituara në llogarinë e tij bankare dhe pjesa tjetër të dhëna hua); (vi) që apartamenti në fjalë është shitur nga z. F. D. te persona të tretë, në vitin 2019; (vii) që nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni nuk ka rezultuar ekzistenca e ndonjë konflikti interesash midis subjektit dhe z. F. D.¹⁷ – trupi gjykues nuk ka gjetur elementë faktiko-ligjorë në bazë të të cilëve z. F. D. të kualifikohej si një person tjetër i lidhur në kuptimin e pikës 4, të nenit 32, ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, të mund t’i kalohej barra e provës subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie.

2. Automjet tip “Audi A4”, viti i prodhimit 2006, me vlerë 500,000 lekë

15. Subjekti ka deklaruar automjetin tip “Audi A4”, me targa ***, për herë të parë në DIPP-në e vitit 2015 dhe më pas në deklaratën *Vetting*. Në DIPP-në e vitit 2015, si burim krijimi i kësaj pasurie janë përshkruar të ardhurat e familjes, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim, një pjesë të të ardhurave prej 2,000,000 lekësh të dhuruara nga familja e tij e origjinës, të përfituara nga shitja e pasurisë “lokal” me sip. 40 m², në Poliçan, Skrapar dhe kursimeve nga veprimtaria e tyre tregtare.
16. Lidhur me mospërputhjen midis burimit të deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se: “Në

¹⁵ Duke qenë se apartamenti në përdorim nga subjekti i rivlerësimit është shitur në vitin 2019 nga pronari F. D.

¹⁶ Kontratë qiraje midis qiradhënësit A. M. dhe qiramarrësit Adriano Dyrmishi, për banesën e ndodhur në katin e parë të banimit me sipërfaqe 61.9 m², në rrugën “****”, kundrejt vlerës 20,000 lekë/muaj me afat 1-vjeçar.

¹⁷ Verifikim i kryer në dy faza, siç është shpjeguar në pjesën e rivlerësimit profesional, ku janë trajtuar edhe verifikimet e tjera mbi konflikte interesi të subjektit edhe me persona të tjerë.

DIPP-në e vitit 2010 (përpara fillimit të detyrës)¹⁸ dhe në deklaratën Vetting kam deklaruar përfitimin e një shume të dhuruar nga prindërit prej 2,000,000 lekësh, ku një pjesë e kësaj shume prej 500,000 lekësh është përdorur për blerjen e automjetit tip 'Audi A4'. Që prej fundit të vitit 2009 e në vazhdim, kjo shumë lekësh e dhuruar nga prindërit është e familjes sime (bashkëshorte dhe fëmijë) dhe për këtë arsye dhe këtë kuptim është përdorur shprehja (me burim nga të ardhurat e familjes) në deklaratën e vitit 2015.”

17. Automjeti në fjalë është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.7.2015, të lidhur midis palës shitëse shtetasit A. H. dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, kundrejt çmimit 500,000 lekë.
18. Ky automjet rezulton se më parë pala shitëse e kishte blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2015, nga shtetasi E. Xh.¹⁹, kundrejt çmimit 7,000 euro. Nga një vlerësim krahasimor është konstatuar se vlera e blerjes së automjetit nga shtetasi A. H. prej 7,000 euro më 23.3.2015, ka qenë më e lartë²⁰ se çmimi i shitjes në favor të subjektit të rivlerësimit, më 13.7.2015, kundrejt vlerës prej 500,000 lekësh.
19. Lidhur me këtë diferencë çmimesh, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, se: “[...] Çmimi i vendosur për automjetin ishte 5,000 euro. Pas konsultimeve me familjen dhe duke parë problematikat e automjetit unë kam bërë një ofertë prej 500,000 lekësh. Pas rreth 15 ditëve, oferta e bërë prej meje është pranuar dhe kemi shkuar pranë noterit për të bërë kontratën e shitjes me një person të autorizuar me prokurë nga pronari i automjetit. Shuma e lekëve të blerjes së automjetit është dhënë cash ditën e blerjes së kontratës para noterit. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2020 kam administruar dosjen e automjetit tim tip 'Audi A4', viti i prodhimit 2006. Nga studimi i bërë dokumentacionit të kësaj dosjeje vërehet se ky automjet është shitur me kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015 me vlerën 5,000 euro, çka i përshtatet pothuaj vlerës reale të automjetit, nisur nga referencat doganore dhe tregut të automjeteve në atë periudhë. Shitja e këtij automjeti, pas pothuaj një muaji me vlerë 7,000 euro (2,000 euro më shumë) duket sa e pakuptimtë aq dhe jo në përputhje me vlerën reale të automjetit, gjë për të cilën tani që administrova dosjen e automjetit kam rënë në dijeni.”²¹
20. Lidhur me analizimin e kësaj pasurie, Komisioni ka administruar dokumentacionin në vijim:

¹⁸ Ndërkohë, konstatohet se në deklaratën përpara fillimit të detyrës, dorëzuar më 24.2.2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje cash të siguruar nga të ardhurat personale dhe familjare, në masën 2,000,000 lekë dhe nuk ka deklaruar dhurimin e shumës prej 2,000,000 lekësh nga prindërit e tij në asnjë nga deklaratat periodike, përveçse në deklaratën Vetting.

¹⁹ Shtetasi E. Xh. ka blerë automjetin nga shtetasi M. M., me anë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015, nga ky i fundit me vlerën prej 5,000 euro.

²⁰ Ekuivalenti i 7,000 euro është 983,150 lekë, referuar kursit të këmbimit të datës së blerjes së automjetit 23.3.2015, nga z. A. H., ku 1 euro këmbehej me 140.45 lekë.

²¹ Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2020, i kërkoi informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2020, pas verifikimit në indeksat e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore 2015 e deri tani nuk ka rezultuar që ndaj shtetasve të jetë regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penal në ngarkim të tyre.

- i. DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2020²² ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, rezulton i regjistruar automjeti me targa ***.
- ii. Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.7.2015, ku shtetasi A. H.²³ nëpërmjet përfaqësuesit të tij me autorizim, E. H., i ka shitur subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, automjetin tip “Audi A4” kundrejt vlerës 500,000 lekë.
- iii. Deklaratë me shkrim dore²⁴ e datës 14.10.2009, e prindërve të subjektit të rivlerësimit, jo në prani të noterit publik, të cilët kanë deklaruar se i kanë dhuruar djalit të tyre të vetëm, Adriano Dyrmishi, shumën prej 2,000,000 lekësh nga të ardhurat nga shitja e lokalit në vlerën 1,199,500 lekë dhe një pjesë të kursimeve familjare.
- iv. Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., e datës 17.6.2005, për shitjen e pasurisë truall dhe ndërtesë (lokal) me sip.40 m², me nr. pasurie ***, në Poliçan, Skrapar kundrejt vlerës 1,199,500 lekë, me palë shitëse shtetasin G. D. dhe palë blerëse Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.
- v. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.9.2019, “Raiffeisen Bank” ka vendosur në dispozicion lëvizjet e llogarive në të cilat është konstatuar transferimi i shumës prej 1,199,500 lekësh nga Drejtoria Rajonale Shëndetësore Berat në llogari të z. G. D., në datën 28.6.2005²⁵.
- vi. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2019, ASHK - Skrapar ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të nuk figurojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara.
- vii. QKB-ja ka konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2019 se z. G. D. ka qenë i regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar më 24.2.1993 me objekt “shitjen e artikujve të ndryshëm” dhe me vendim të Gjykatës Skrapar më 1.9.1994, regjistruar për ushtrimin e aktivitetit së bashku me bashkëshorten, por të papajisur me NIPT.
- viii. Nga përgjigjja e DPT-së me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2019, nuk rezultojnë të dhëna mbi aktivitetet e mësipërme në sistemin tatimor.
- ix. Bashkia Poliçan ka konfirmuar gjithashtu me anë të shkresës nr. *** prot., datë 14.8.2017 se nuk ka asnjë lloj dokumentacioni pranë këtij institucioni për aktivitetin e shtetasit G. D.

2.1 Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie:

²² Shkresa me nr. *** prot., datë 5.5.2020 është depozituar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, kthim-përgjigje i kërkesës me nr. *** prot., datë 4.5.2020, të bërë nga subjekti i rivlerësimit pranë këtij institucioni.

²³ Shitësi A. H. është përfaqësuar në këtë kontratë nga E. H., me anë të një autorizimi të nënshkruar pranë qendrës së shërbimeve për shtetasit e Republikës Greke, në Athinë, datë 20.6.2015. Dokumenti është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, por nuk ka vulë apostile.

²⁴ Deklarata mban datën 14.10.2009, firmosur nga prindërit e subjektit të rivlerësimit.

²⁵ Këto fonde janë tërhequr nga llogaria në datën 30.6.2005, nga z. G. D.

21. Në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në masën 2,000,000 lekë, me burim nga të ardhurat personale dhe familjare, me pjesë takuese 50 %.
22. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar shumën prej 2,000,000 lekësh si dhuratë nga familja e origjinës, me burim krijimi nga shitja e pasurisë lokal dhe nga aktiviteti tregtar, si dhe gjendja në momentin e deklaramit ka qenë në vlerën 1,400,000 lekë.
23. Lidhur me mospërputhjen e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit sa i takon burimit të krijimit të shumës së dhuruar, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “[...] Unë kam përfituar një shumë të dhuruar nga familja (babai dhe nëna) prej 2,000,000 lekësh të reja në fundin e vitit 2009. Pak nga të ardhurat e kësaj shume, të gjendur në banesën time që prej asaj kohe, janë përdorur për nevoja të ngutshme familjare dhe përsëri kjo shumë plotësohej nga të ardhurat mujore (rrogë burrë dhe grua). Në janar të vitit 2010 unë jam shtuar me një vajzë dhe kam përdorur për nevoja familjare një pjesë fare të vogël nga shuma e lekëve të dhuruara nga prindërit. Kjo shumë është plotësuar muajt në vazhdim. Është pikërisht ky fakt që është përdorur në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2010, shprehja (të ardhurat personale dhe familjare) [...]”.
24. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume të dhuruar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e shitblerjes nr. *** rep., të datës 17.6.2005, me palë shitëse G. D. dhe palë blerëse Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Berat, kundrejt çmimit 1,199,500 lekë.
25. Gjithashtu, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe dokumentacionin mbi të ardhura të përfituara nga prindërit e tij, si vijojnë:
 - i. vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga DRT-ja Berat, në të cilin shprehet se aktiviteti i shtetasit G. D. ka qenë aktiv deri në prill të vitit 1996 dhe se nuk ka detyrime të papaguara, por pa të dhëna mbi fitime të realizuara;
 - ii. vërtetim nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga Këshilli i Qarkut Berat për të ardhurat e përfituara nga shtetasi G. D., si anëtar i këtij Këshilli, në vlerën 244,460 lekë, për periudhën maj 2004 – shkurt 2007;
 - iii. vërtetim nr. *** prot., datë 11.4.2019, nga Bashkia Poliçan për të ardhurat e realizuara nga shtetasi G. D. në vlerën 301,895 lekë, gjatë periudhës tetor 2000 – shkurt 2007, si anëtar i Këshillit Bashkiak Poliçan;
 - iv. vërtetim i datës 28.6.2019, i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi G. D. në vlerën 1,361,667 lekë, gjatë periudhës 2003 – tetor 2009, si anëtar i Këshillit të Gjyshitës Bektashiane Skrapar;
 - v. vërtetim nr. *** prot., datë 6.7.2020, nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Berat për të ardhurat e realizuara nga paga e nënës L. D., në vlerën 1,965,974 lekë, gjatë periudhës 2000 – tetor 2009²⁶;

²⁶ Rezultoni të ketë qenë e punësuar gjatë kësaj periudhe në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Bashkinë Poliçan dhe Qendrën Shëndetësore Poliçan.

vi. vërtetim nr. *** prot., datë 6.7.2020, nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Berat për të ardhurat e realizuara nga paga e babait G. D., në vlerën 1,969,318 lekë, gjatë periudhës 2000 – tetor 2009²⁷.

26. Në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit, që kanë mundur të pas dhurimin e shumës prej 2,000,000 lekësh në vitin 2009.

Tabela nr. 1: të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit në periudhën 2000 – 2009

TE ARDHURAT	SHUMA
Te ardhura nga shitja e lokalit ne Polican	1,199,500
Te ardhura nga paga L. D.	1,965,974
Te ardhura nga paga G.D.	1,969,318
Te ardhura nga Keshilli Qarkut Berat	244,460
Te ardhura nga Keshilli Bashkiak Polican	301,895
Te ardhura nga Keshilli Gjyshates Bektashiane Skrapar	1,361,667
TOTALI I TE ARDHURAVE	7,042,814
Shpenzimet e jeteses (2000-Tetor 2009)	- 2,152,257
Dhuarat djalit shuma prej 2,000,000 Leke	- 2,000,000
REZULTATI	2,890,557

27. Nga sa më lart, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, mbi të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe pas përlogaritjes së burimeve të tyre e zbritjes së shpenzimeve jetike²⁸, ka rezultuar se ata kanë pasur mundësi që të kursenin²⁹ me burime të ligjshme financiare dhe t'i dhuronin djalit të tyre, shumën prej 2,000,000 lekësh.
28. Gjithashtu është konstatuar se në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë pakësim të gjendjes *cash* të disponuar në banesë. Këtë pakësim nga shuma 2,000,000 lekë në shumën 1,400,000 lekë³⁰ e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* dhe, në këto kushte, fondet e pretenduara si të përdorura nga një pjesë e gjendjes *cash* nuk mund të konsiderohen si burim për blerjen e automjetit në fjalë, për sa kohë ky veprim pakësimi nuk është deklaruar në vitin përkatës, siç parashikohej dhe kërkohej nga dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet nënligjore sqaruese.
29. Rrjedhimisht, për blerjen e këtij automjeti në datën 13.7.2015, Komisioni ka përlogaritur të ardhurat e disponueshme që kanë rezultuar të tërhequra nga llogaritë bankare, si nga subjekti i rivlerësimit dhe nga bashkëshortja e tij, deri në datën e kryerjes së transaksionit,

²⁷ Pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar.

²⁸ Llogaritur për dy persona, në bazë të të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.

²⁹ Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar gjithashtu se: “Nga komunikimi me prindërit e mi, mesa u kujtohet, kam mësuar se një pjesë e shumës prej 1,199,500 lekësh nga viti 2005, nga shitja e ambientit tregtar në pronësi të tyre, mbahej në bankë, ndërsa pjesa tjetër dhe kursimet e tyre në vite mbaheshin në banesën e tyre me adresë Poliçan Skrapar.”

³⁰ Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjendja *cash* në banesë është ulur nga 2,000,000 lekë në 1,400,000 lekë, pasi me këto fonde është blerë automjeti dhe janë kryer shpenzime familjare si lindja e fëmijës, etj.

si dhe duke zbritur shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë dhe ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme në atë datë në vlerën prej – 379,287 lekësh.

Tabela nr. 2: burimet e përdorura për blerjen e automjetit

PERSHKRIMI	SHUMA
Terheqje nga llogarite deri ne 13.07.2015	604 000
Shpenzime deri ne 13.07.2015	- 483 287
Blerja e automjetit	- 500 000
REZULTATI NE 13.07.2015	- 379 287

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

30. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, është shprehur si vijon:

i. “Së pari – ashtu siç kam sqaruar edhe gjatë hetimit administrativ, përpara se të realizohej blerja e këtij automjeti që ishte ofruar për shitje në vlerën 5,000 euro, duke e vendosur këtë çmim, në tabelë mbi automjet, pasi kam vlerësuar gjendjen teknike të automjetit në bisedë me shitësin, është dakordësuar çmimi 500,000 lekë, i cili është pasqyruar rregullisht në kontratën noteriale të shitjes. Dokumenti ‘kontratë shitblerje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.7.2015’, është një dokument me fuqi të plotë provuese. Në vendimin nr. 13, datë 20.6.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndër të tjera thuhet se: ‘Trupi gjykues vlerëson se bazuar në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë, kur është rasti, edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, si dhe në Kodin e Procedurës Civile’. Ndodhur në këto kushte, lidhur me provat e vlerën e tyre provuese, çmoj t’i referohem dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Kështu, në nenin 253 nën titullin ‘Aktet zyrtare’ të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se ‘Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar’. Akoma më tej, në nenin 273 të Kodit të Procedurës Civile, nën titullin ‘Provimi i falsitetit të një shkrese’ parashikohet se: ‘Kush pretendon falsitetin e një shkrese është njëkohësisht i detyruar të paraqesë ato shkresa që vërtetojnë falsitetin dhe të tregojë emrat e dëshmitarëve ose mjetet e tjera provuese, përndryshe pretendimi i tij është i papranueshëm’. Në këtë kushte vlerësoj se konkluzioni i nxjerrë nga KPK-ja, duhet të mbështetet në parashikimet e neneve 253 dhe 273 të Kodit të Procedurës Civile dhe me provat e administruara nga vetë KPK-ja gjatë hetimit administrativ.

Komisioni ngre dyshime mbi vlerën e blerjes së automjetit, bazuar në faktin se shitësi i këtij automjeti, shtetasi A. H., e ka blerë këtë automjet sipas kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2015, me palë shitëse E. Xh., në vlerën 7,000 euro. Por nga ana tjetër, vetë shtetasi E. Xh. e ka blerë automjetin me anë të kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015, nga shtetasi M. M. në vlerën 5,000 euro. Pra, vlera e

automjetit nga muaji shkurt 2015 deri në korrik të këtij viti ka ndryshuar nga 5,000 euro në 500,000 lekë. Ky ndryshim i vogël në vlerë, nuk mund të përbëjë as indicie për të ngritur dyshime mbi çmimin e këtij automjeti, duke pasur parasysh se çmimi në tregun e automjeteve të përdorura është shumë variabël.

- ii. Së dyti – vlerësoj se deklaratimet e bëra në deklaratën Vetting nuk bien në kundërshtim me deklaratën e bërë përpara fillimit të detyrës. Në deklaratën Vetting, për shkak edhe të parashikimeve të reja të ligjit nr. 84/2016, por edhe akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, deklaratimet janë bërë më të plota. Unë kam familjen time të origjinës edhe familjen time të re dhe, për këtë arsye, në deklaratën Vetting kam shtuar fjalën ‘të origjinës’, për të qenë sa më i saktë. Edhe në këto prapësime ritheksoj se vlera 2,000,000 lekë më është dhuruar nga babai im në fund të vitit 2009, ashtu siç vërteton edhe deklarata e nënshkruar prej tij dhe e paraqitur në Komision. Në janar të vitit 2010, një pjesë e vogël e këtyre të ardhurave është shpenzuar në momentin e ardhjes në jetë të fëmijës tim të parë. Në momentin e plotësimit të deklaratës përpara fillimit të detyrës, vlera cash në banesë është plotësuar nga kursimet e mia edhe të bashkëshortes, përsëri, në shumën 2,000,000 lekë (për këtë arsye është përdorur shprehja ‘të ardhurat personale dhe familjare’). Edhe në vitet në vazhdim, brenda vitit (1.1.-31.12) ka ndodhur që të jetë shpenzuar një pjesë e gjendjes cash për nevoja të ngutshme, por deri në fund të vitit 2014, gjendja cash nuk ka ndryshuar. [...].
- iii. Së treti – Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të blerë automjetin në muajin korrik të vitit 2005 dhe konstaton një diferencë negative në vlerën - 379,287 lekë (ose - 342,303 lekë) në fund të vitit. Theksoj se automjeti është blerë duke pakësuar gjendjen cash në vitin 2015 nga 2,000,000 lekë në 1,500,000 lekë. Kam vlerësuar se duke deklaruar si burim kursimet familjare, automatikisht deklarohej edhe zvogëlimi i gjendjes cash. Kjo mënyrë të kuptuari nga ana ime, vërtetohet edhe nga deklaratimet e bëra në deklaratën Vetting, në të cilën gjendja cash është deklaruar në vlerën 1.400.000 lekë, si dhe burimi i krijimit të këtij automjeti është deklaruar: ‘një pjesë të të ardhurave prej 2,000,000 lekësh të dhuruara nga familja e tij e origjinës’. Për këtë arsye duhet të përllogaritet në analizën financiare edhe zvogëlimi i gjendjes cash. Analiza financiare, në momentin e blerjes së automjetit, paraqitet në tabelën e mëposhtme, duke rezultuar me balancë pozitive në vlerën 121,213 lekë.

Përshkrimi	Shuma/ kpk	Shuma/subjekti
Tërheqje nga llogaritë	604 500	604 500
Shpenzime-13.07.2015	483 287	483 287
Blerje automjeti	500 000	500 000
Pakësim i gjendjes cash		- 500 000
Diferenca	- 379 287	121 213

- iv. Së katërti, KPK-ja deklaron në gjetjen e fundit se: ‘edhe sikur të merret në konsideratë versioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me disponibilitetin e gjendjes cash në vitin 2015, të mbartur nga vitet pararendës dhe të shpenzuar në vlerën 500,000 lekë për këtë pasuri, do të rezultonte pamjaftueshmëria e deklaratës periodike në fjalë’.

Edhe ky konkluzion i KPK-së nuk qëndron sepse nëse diferenca negative, referuar përlllogaritjeve të kryera nga KPK-ja, në fund të vitit është në shumën - 342,303 lekë dhe mosllogaritja e zvogëlimit të gjendjes cash është në shumën 500,000 lekë, atëherë balanca në fund të vitit është pozitive në vlerën 121,213 lekë.

Deklarimet e mia në lidhje me pakësimin e gjendjes cash janë tërësisht të vërteta dhe mbështeten nga analiza logjike e provave të administruara gjatë hetimit administrativ. Sipas analizës financiare të kryer nga vetë KPK-ja, viti 2015 është i vetmi vit ku KPK-ja ka konstatuar diferencë negative. Ky fakt është një argument më shumë që duhet të bindë KPK-në, se mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes cash është vetëm një pasaktësi e kryer nga ana ime, që rrjedh nga mënyra e të kuptuarit të formës së deklarimit. Për sa më sipër, vlerësoj se kam deklaruar me vërtetësi automatjetin dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për blerjen e tij.”

Vlerësimi i trupit gjykues

31. Lidhur me mospërputhjen e konstatuar midis deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë në fjalë (automjetit) në DIPP-në e vitit 2015, krahasuar me deklaratën *Vetting*, pasi në të parën burimi deklarohet nga të ardhurat nga familja, ndërsa në të dytën është deklaruar nga të ardhurat e dhuruara nga prindërit e tij, vlerësohet se gjendemi përballë një mospërkimi në *prima facie* qw ka diktuar nevojën e qartësimit të konceptimit të familjes, që sikurse subjekti ka shpjeguar, rezultoi se si në njërin rast dhe në tjetrin referenca faktike ka qenë e njëjtë: (i) kursimet e disponueshme prej tij në momentin e blerjes; të cilat (ii) rridhnin pikërisht nga shumat e dhuruara më herët nga prindërit e tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit.
32. Edhe lidhur me mospërputhjen e konstatuar midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës dhe deklaratës *Vetting* – sa i përket burimit të krijimit të shumës prej 2,000,000 lekësh, në deklaratën para fillimit të detyrës burimi është deklaruar nga të ardhurat personale dhe familjare, ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar si burim dhurimi nga familja e tij e origjinës – arsyetimi dhe konkluzioni i trupit gjykues është i njëjtë me atë të shprehur në pikën e mësipërme, për sa kjo rrethanë përthith të njëjtën dinamikë dhe mbart të njëjtat shkaqe.
33. Lidhur me konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në masën -379,287 lekë³¹, për sa kohë nuk është deklaruar përdorimi i fondeve të disponuara *cash* në banesë, referuar deklarimit të tij në DIPP-në e vitit 2015, pavarësisht shpjegimeve logjike të subjektit lidhur me mënyrën e konceptimit të tij në përshkrimin e deklarimit vjetor dhe faktit që Komisioni nuk mund të konkludojë për pamundësinë konkrete të përdorimit të shumave të pretenduara nga subjekti në vitin 2015 (përkundrazi, kjo mundësi duket e besueshme) mbetet pamjaftueshmëria formale në deklaram, që nuk e mundëson konsiderimin e kësaj shume në analizën financiare, për sa kohë nuk është deklaruar pakësimi i gjendjes *cash*. Ky mosdeklarim, ndonëse përbën një pasaktësi e cila, e ndërthurur me dy stuatat faktike që

³¹ Rezultati prej – 379,287 lekësh vjen si pasojë e përlllogaritjes së burimeve të pasurisë deri në momentin e kryerjes së transaksionit. Ndërkohë, analiza e vitit 2015 rezulton me një balancë negative në masën – 342,303 lekë, për shkak të konsiderimit në të, të të gjitha të ardhurave të vitit.

shprehura lidhur me deklarin periodik të vitit 2015, nisur edhe nga rrethanat e tjera specifike të sipërpërmendura, trupi gjykues çmon se sikurse edhe pamjaftueshmëria financiare (formale) e konstatuar, për të njëjtin vit (2015), duke konsideruar peshën specifike minimale që mbartin, në raport me këtë proces rivlerësimi të parë në tërësinë e tij, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

3. Të ardhura të përfituara nga bashkëshortja e subjektit, në masën 375,000 lekë

34. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, të ardhura në masën 375,000 lekë, të përfituara nga shitja e pjesës takuese të një pasurie në bashkëpronësi, por ende të padisponuara.
35. Konkretisht, në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar shitjen e pasurisë të llojit “arë” me anë të kontratës nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 17.10.2016, me vlerë totale 1,500,000 lekë, nga e cila ka përfituar të ardhurat prej 375,000 lekësh, shumë kjo e padisponuar ende nga prej saj.
36. Kjo pasuri e llojit “arë” rezulton të jetë përfituar nga familja e bashkëshortes, nëpërmjet Aktit nr. ***, datë 12.5.1995, të marrjes së tokës në pronësi, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991.
37. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. Aktin me nr. ***, datë 12.5.1995, të AMTP-së, për njohjen e pronësisë së sipërfaqes totale 4,000 m², me nr. pasurie ***, në emër të babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, N. D.³², të ndodhur në Grecalli, Fier.
 - ii. Certifikatë pronësie nr. ***, për pasurinë e llojit arë, me sip. 3,928 m², në emër të z. N. D., me përshkrimin (F-familjare), lëshuar më 12.12.2011.
 - iii. Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 17.10.2016, në të cilën pala shitëse N. D., A. D., J. D. dhe L. D., i ka shitur palës blerëse V. T. dhe A. T., pasurinë e paluajtshme me nr. *** përkundrejt çmimit 1,500,000 lekë.
38. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni është konstatuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk e ka deklaruar më herët në rubrikat përkatëse, nga DIPP-ja e vitit 2010 e në vazhdimësi deri në vitin 2016, bashkëpronësinë mbi pasurinë e paluajtshme “arë” me sip. prej 4,000 m², ndodhur në Grecalli, Fier.
39. Nga lëvizjet bankare është konfirmuar kalimi i shumës prej 1,499,950 lekësh nga llogaria e noteres A. H. P. F., në llogari të babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, N. D., në “Raiffeisen Bank”, në datën 2.11.2016 dhe të tërhequr prej tij në datën 3.11.2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

³² Gjithashtu, nga informacioni i ZRPP-së Fier me e-mailin e datës 1.10.2018 rezulton se në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, N. dhe A. D., figuron e regjistruar pasuria e paluajtshme me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit ndërtesë me sip. 72.4 m², e regjistruar me leje legalizimi nr. ***, datë 30.9.2016. Bashkëngjitur praktikës ndodhet edhe kartela e pasurisë në emër të N. D., si dhe praktika e lejes së legalizimit.

40. Lidhur me këtë rrethanë, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit duke i kërkuar shpjegime mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në asnjë nga deklaratat e tij periodike deri në vitin 2016. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit, është shprehur se: *“Kjo pasuri është përfituar në vitin 1992 me kryefamiljar N. D. (babai i bashkëshortes) në fshatin Grecalli Fier. Në atë periudhë bashkëshortja ime ka qenë e mitur (9 vjeçe). Unë jam martuar me bashkëshorten time në vitin 2008. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP Fier në vitin 2011, plot tre vjet pasi bashkëshortja ime nuk bënte më pjesë në trungun familjar të familjes së saj mëmë. Për shitjen e kësaj pasurie, prindërve të bashkëshortes u është kërkuar nga noteri në Fier, nënshkrimi i të gjithë pjestarëve të familjes që kanë qenë në certifikatën familjare në vitin 1992 dhe, rrjedhimisht, është thirrur për të firmosur edhe bashkëshortja ime J. D. Ky ka qenë momenti i marrjes dijeni prej saj për pasurinë në fjalë, pasi është konsideruar formalisht dhe ligjërish si jo pjesëtare e kësaj pasurie që pas martesës në vitin 2008”.*
41. Gjithashtu, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pikë, veç të tjerash, ka shpjeguar e argumentuar si vijon:
- i. *“Ashtu siç kemi sqaruar gjatë hetimit administrativ, në momentin e lëshimit të aktit të marrjes së tokës në pronësi, bashkëshortja ka qenë e mitur dhe nuk ka pasur dijeni ligjore dhe faktike për marrjen e tokës në pronësi sipas AMTP-së së sipërcituar. Prona është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier në vitin 2011, disa vite pas martesës së saj (disa vite pasi ajo ishte larguar prej familjes bujqësore).*
 - ii. *Praktika e regjistrimit të kësaj pasurie në ZRPP Fier, ashtu siç përcaktohet edhe në aktet nënligjore është ndjekur nga kryetari i familjes bujqësore, z. N. D. Në momentin e regjistrimit nuk lëshohet ndonjë prokurë e posaçme nga anëtarët e familjes bujqësore ose personat që kanë qenë në certifikatën e trungut familjar në datën 1.8.1991 (mjafton vetëm dorëzimi i kësaj certifikate).*
 - iii. *Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., të datës 17.10.2016, shitësit N. D., A. D., J. D. dhe L. D., i kanë shitur këtë pasuri palës blerëse V.T. dhe A. T., përkundrejt çmimit 1,500,000 lekë. Vlera 375,000 lekë e deklaruar në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën Vetting përfaqëson ¼ e vlerës totale të tokës së shitur. Është pikërisht ky momenti, në të cilën bashkëshortja deklaroi se ka marrë dijeni se ishte pronare në ¼ të pasurisë së sipërcituar.*
 - iv. *Bashkëshortja jo vetëm nuk ka pasur dijeni të plotë në lidhje me përfitimin e tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, por në vlerësim të saj, toka bujqësore është në pronësi të anëtarëve të familjes bujqësore, e cila është një organizim që ndryshon me kalimin e kohës, pasi anëtarët e saj nuk janë të përjetshëm. Në familjen bujqësore mund të vijnë anëtarë për shkak të martesës, për shkak të pranimit të anëtarëve të rinj ose e kundërta.*
 - v. *Sipas nenit 222 të Kodit Civil ‘pasuria e familjes bujqësore është në bashkëpronësi në tërësi të anëtarëve të familjes bujqësore, të cilët me punë apo në mënyra të tjera kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e familjes bujqësore’. Pra, anëtarët e*

familjes bujqësore janë bashkëpronarë në tërësi kur kanë kontribuar jo vetëm me krijimin e familjes bujqësore, por edhe në mbajtjen e saj, pasi dispozita ka të vendosur lidhëzën ‘e’ jo ‘ose’. Ndërsa në nenin 223 të Kodit Civil përcaktohet se: ‘Anëtarët e familjes bujqësore janë të lidhur me njeri-tjetrin për shkak gjinie, martesë, birësimi apo pranimi si anëtarë të saj’. Gjithashtu, në nenin 227 të Kodit Civil parashikohet mënyra e përcaktimit të pjesës së anëtarit të familjes bujqësore. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë familjen bujqësore, anëtarët e familjes bujqësore janë ata që kontribuojnë dhe punojnë së bashku për krijimin e shtimit e pasurisë së familjes bujqësore dhe në varësi të kontributit të tyre për krijimin apo shtimin e pasurisë së familjes bujqësore, përcaktohet edhe pjesa e tyre në këtë familje.

- vi. *Bashkëshortja ime nuk ka kontribuar asnjëherë me punën e saj në mbajtjen e familjes bujqësore. Për shkak të interpretimit të ligjit të sipërcituar, por edhe për shkak se nuk e ka njohur aktin e marrjes së tokës në pronësi, ajo nuk e ka poseduar dhe konsideruar ndonjëherë pronësinë mbi këtë sipërfaqe toke dhe, për këtë arsye, nuk e ka deklaruar pronësinë në DPV-të vjetore.*
- vii. *Meqenëse kjo tokë bujqësore u vendos të shitej nga familja bujqësore në vitin 2016, noteri ka vlerësuar se bashkëshortja është pronare në ¼ e kësaj sipërfaqeje dhe ka kërkuar që në përpilimin e aktit të shitblerjes me cilësinë e shitëses duhet të ishte edhe ajo. Në këtë moment bashkëshortja ka mësuar tërësisht situatën faktike dhe ligjore mbi këtë pasuri të përfitur në vitin 1995. Për këtë arsye, ky veprim juridik dhe vlera e përfitur de juro prej këtij veprimi është pasqyruar në DPV-në e vitit 2016 ashtu edhe në deklaratën Vetting.*
- viii. *Si rrjedhojë, mosdeklarimi i pronësisë mbi këtë sipërfaqe toke bujqësore nga ana e bashkëshortes ka ardhur për shkak tërësisht objektive. Kuptohet qartësisht nga aktet e administruara, si edhe nga sjellja e bashkëshortes se në rastin konkret, mosdeklarimi ka ndodhur për arsye tërësisht objektive që lidhen me situatën faktike të krijimit dhe regjistrimit të kësaj pasurie. Burimi i kësaj pasurie është tërësisht i ligjshëm, përfitur në bazë të një akti administrativ, i cili është lëshuar në bazë të ligjit nr. 7501/1991. Nuk ka asnjë të dhënë sado minimale, që të krijojë dyshime për ndonjë qëllim të ndryshëm nga ai që deklaroi bashkëshortja për mosdeklarimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, ashtu si edhe vetë Komisioni ka vlerësuar, ky mosdeklarim nuk përbën në fakt një gjetje, për të cilën subjekti mund të ngarkohet me barrë prove apo me detyrimin për të dhënë shpjegime.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

- 42. Nga analiza e rrethanave faktike të rezultuara nga dokumentacioni i administruar dhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit – përtej faktit që mospasja dijeni e bashkëshortes, lidhur me të drejtat e saj reale mbi një pasuri të paluajtshme, ndonëse nuk mund të përjashtohet si mundësi, ajo mbetet në nivel deklarativ – trupi gjykues, nisur nga ekzistenca e disa rrethanave faktike, si: [(i) mungesa e kontributit për krijimin e kësaj pasurie, jo vetëm nga personi në fjalë por as nga familjarët e saj, për sa kohë toka *de qua* është përfitur në zbatim të ligjit nr. 7501/1991; (ii) për sa kohë nuk ka pasur shpenzime

për blerjen e kësaj pasurie, nuk mund të kishte as interes (hipotetik) për fshehje të investimit të kryer (për pamundësi burimesh të ligjshme); (iii) fakti që gjithsesi bëhet fjalë për një pasuri të krijuar nga familja e një personi të lidhur (kur ajo ishte ende e mitur) etj.], dhe duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelistit lidhur me temën e pasojave që mund të rrjedhin nga mosdeklarimet apo nga pamjaftueshmëria e deklaratave periodike³³, çmon se situata faktike e analizuar më sipër nuk mund të shkaktojë pasoja për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë nuk plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 5, të nenit 33 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare

43. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, lidhur me të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre janë kryer vlerësimet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
44. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2010, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti, në ILDKPKI, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën -342,303 lekë, siç është detajuar në tabelën më poshtë.

³³ Veç të tjerash, shihni vendimet nr. 11 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 11; 13; 22 (JR), 2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelistit.

Analiza financiare për periudhën 2010 - 2016

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	-10,701	97,568	-83,610	-516	-22,581	527,921	21,183
Automjet tip Benz 190D, Viti 1992							
Automjet tip Audi A4, viti 2006						500,000	
Ndryshim likuiditeti	-10,701	97,568	-83,610	-516	-22,581	27,921	21,183
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	1,978,729	2,076,297	1,992,687	1,992,172	1,969,591	1,997,512	2,018,695
DETYRIME	-54,723	-47,803	0	0	0	0	0
Kredi ne RZB 150,000 leke me afat 3 vjecar	-54,723	-47,803					
PASURI NETO	44,022	145,371	-83,610	-516	-22,581	527,921	21,183
Të ARDHURA dokumentuar	1,003,553	1,216,564	1,244,130	978,420	1,065,779	1,131,055	1,526,222
Te ardhura SR vertetuar	938,225	935,659	949,428	873,394	1,065,779	1,051,933	1,049,214
Te ardhura BSH vertetuar	65,328	280,905	294,702	105,026	-	79,122	477,008
SHPENZIME	425,619	577,136	743,082	514,868	765,673	945,437	853,808
Shpenzime jetese	409,860	409,860	423,072	423,072	659,994	672,828	764,049
Shpenzime interesi kredie RZB 150,000 leke	15,759	4,130					
Shpenzime udhetimi		163,146	320,010	77,116	105,679	272,609	74,399
Shpenzime per polica sigurimi				14,680			15,360
Analiza dokumentuar	533,912	494,057	584,658	464,068	322,687	-342,303	651,231
CASH në lekë	2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000
DIFERENCA E PA MBULUAR	-342,303						

45. Në përfundim, trupi gjykues, pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se duke e parë çështjen nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit dhe duke e vlerësuar në tërësinë e tij kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi (sikurse jemi shprehur edhe në paragrafin nr. 33) – balanca negative e sipërpërmendur, sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet vjetore, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

46. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision një raport me nr. *** prot., datë 2.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi.
47. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim, më 8.6.2020 është përcjellë nga DSIK-ja raporti vijues me nr. *** prot., i datës 13.5.2020, nëpërmjet të cilit Grupi i Punës ndryshon konstatimin nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit z. Adriano Dyrmishi.

48. Gjithashtu, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar pjesërisht, më 4.6.2020, me vendimin nr. *** të KDZH-së.
49. Në këtë raport, veç të tjerash përshkruhej ekzistenca e informacioneve në bazë të të cilave subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme, në vitet 2016 dhe 2018, me një person mbi të cilin kishte dyshime serioze për përfshirjen e tij në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.
50. Në vijim të sa më lart, anëtarët e trupit gjykues, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar, janë njohur me materialet e klasifikuara në të cilat gjendeshin të dhënat e personit dhe të komunikimeve përkatëse. Më pas, Komisioni ka kryer hetime shtesë në mënyrë të pavarur, lidhur me rrethanat specifike të fakteve mbi të cilat bazoheshin konkluzionet e Grupit të Punës.
51. Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me procedime apo dënime të mundshme në ngarkim të një shtetasi.
52. Prokuroria e Përgjithshme vuri në dispozicion dokumentacionin nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, nga ku nuk rezultoi asnjë informacion apo çështje e gjykuar në ngarkim të shtetasit në fjalë.
53. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer për periudhën 2010 – 2020, ka rezultuar se ndaj këtij shtetasi janë regjistruar tre kallëzime penale, por nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Adriano Dymishi, të ketë qenë prokuror i ngarkuar për ndjekjen e tyre. Nga ana tjetër, objekti i këtyre kallëzimeve/procedimeve nuk përfshihet mes veprave penale të krimit të organizuar dhe, për rrjedhojë, në këto kushte, shtetasi në fjalë nuk mund të përbënte një kontakt potencial të papërshtatshëm.
54. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë kriter.
55. Në këto kushte, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, duke mos konstatuar prezencën e ndonjë prove lidhur me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme apo përfshirje të subjektit të rivlerësimit në aktivitete të kundërligjshme, sipas parashikimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës – të cilat mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 e konsideron të përshtatshëm z. Adriano Dymishi për vazhdimin e detyrës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

56. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: raportin e përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2019 dhe të përpiluar nga KLP-ja për analizimin e aftësisë profesionale të

subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u bazuar në:

- a. aftësitë profesionale;
 - b. aftësitë organizative;
 - c. etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
 - d. aftësitë personale dhe angazhimin profesional.
57. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizën e: formularit të vetëdeklarimit, si dhe të tri dokumenteve ligjore, të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhëniet me Shërbimet Informative, Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhëniet me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.
58. Sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë periudhës së rivlerësimit për subjektin Adriano Dyrmishi nuk kanë rezultuar masa disiplinore të përfunduara apo në fuqi. Ai është vlerësuar “shumë mirë” sipas akteve të lëshuara nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016.
59. Gjithashtu, nga verifikimet në Zyrën e Informacionit të Klasifikuar dhe në Prokurorinë e Përgjithshme nuk rezulton të ketë të dhëna që kanë të bëjnë me *indicie* apo të dhëna të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillim hetimesh, përfshirje drejtpërdrejtë apo indirekt në veprime të dyshimta, etj. Nga verifikimi në zyrën e protokoll-arkivës, në Prokurorinë e Përgjithshme nuk ka rezultuar të ketë kallëzim apo procedim penal në ngarkim të tij.
60. Vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga KLP-ja mbi aftësitë profesionale, ka qenë pozitiv për subjektin e rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, duke konstatuar se në përgjithësi nga subjekti i rivlerësimit aktet janë të ndërtuara duke përdorur teknikat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, duke u ndarë në pjesën e konstatimit, parashtrimit të rrethanave të faktit dhe analizën e veprimeve të kryera nga i/të pandehuri/it, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si edhe masa dhe lloji i dënimit më i përshtatshëm për të pandehurit.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

61. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet ligjzbatuese, duke analizuar akte/dosje profesionale të administruara për këtë qëllim.
62. Gjithashtu, me qëllim verifikimin e ekzistencës ose jo të rasteve të mundshme të konfliktit të interesave të subjektit të rivlerësimit me personat fizikë apo juridikë³⁴ të lidhur në një

³⁴ Shtetasi F. D. i identifikuar si pronari i apartamentit të përdorur nga subjekti pa kundërshpërblim; shoqëria “****” identifikuar si shoqëria shitëse e apartamentit; shtetasi A. H. i identifikuar si shitësi i automjetit; shtetasi E. H., i identifikuar si përfaqësuesi me prokurë për shitjen e automjetit; shtetasi E. Xh. i identifikuar si shitës i automjetit.

marrëdhënie me të, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2020, duke i kërkuar informacion. Kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2020 informoi se nga verifikimi i kryer dhe nga indekset e statistikave elektronike të procedimeve penale për periudhën kohore 2015 e në vijim, nuk rezultoi të jetë regjistruar kallëzim penal apo procedim penal në ngarkim të tyre. Duke qenë se informacioni i referuar ishte i pjesshëm, pasi në të përshkruhej vetëm periudha 2015 e në vijim, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresat nr. *** prot., datë 27.11.2020 dhe nr. *** prot., datë 1.12.2020, duke i rikërkuar informacion nëse gjatë periudhës 2010 – 2014, nga kjo Prokurori është trajtuar ndonjë kallëzim apo procedim në lidhje me shtetasin F. D³⁵. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresat nr. ***prot., datë 2.12.2020 dhe nr. *** prot., datë 2.12.2020, informoi se pas verifikimit të bërë për këtë shtetas për periudhën 2010 – 2014 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, nuk ka trajtuar asnjë kallëzim apo procedim në ngarkim të shtetasit F. D.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

63. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit – bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 për subjektin e rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, janë paraqitur nga publiku 11 denoncime (4 prej tyre i përkasin të njëjtës shtetase), të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni dhe dokumentacionit të administruar, në disa raste nuk ka gjetur elementë për thellimin e hetimit administrativ, ndërsa në disa prej tyre, pasi janë administruar dhe shqyrtuar materialet përkatëse është konstatuar si vijon:

1. Denoncimi nr. * prot., datë 12.4.2019; denoncimi shtesë nr. *** prot., datë 15.2.2019; denoncimi shtesë nr. *** prot., datë 27.12.2018 dhe denoncimi shtesë nr. *** prot., datë 7.9.2020, të shtetasës E. C.³⁶**

64. Shtetasja E. C. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shpërdorim detyre, shkelje ligji dhe moszbatim të detyrave të lëna nga gjykata, duke vënë në dispozicion kallëzimin penal, foto të ndryshme dhe printime të bisedave telefonike. Sa i përket këtij denoncimi, përveç sa është trajtuar në pikën 1 të kapitullit “Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime”, lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2020, të cilët vunë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se:

i. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 4.5.2016, ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** dhe materialet i janë kaluar për hetime subjektit të rivlerësimit, i cili me vendimin datë 27.9.2016 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se: “[...] *Nuk ndodhemi përpara faktit që të përbëjë vepër penale, pasi konflikti është shkak i një mosmarrëveshjeje juridiko-civile dhe fakti i kallëzuar nuk*

³⁵ Në shkresën nr. *** prot., datë 27.11.2020, germa e fundit e emrit është shënuar me “d”, në shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2020 germa e fundit e emrit të shtetasit është “t”.

³⁶ Shtetasja E. C. ka depozituar ankesën e saj edhe në KLP, çështje e cila është trajtuar në pikën 1 të kapitullit “Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime”.

përmbush elementët objektivë dhe subjektivë të ndonjë vepre penale". Vendimi u ankimua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, datë 10.4.2018 vendosi pranimin e kërkesës dhe prishjen e vendimit nr. *** të Prokurorisë, kthimin për hetime të mëtejshme dhe kryerjen e disa detyrave³⁷.

- ii. Vendimi u ankimua nga Prokuroria³⁸ më 11.4.2018, në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 6.6.2018 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke konkluduar në arsyetimin e saj se vendimi i mosfillimit të procedimit penal nr. ***, duhet prishur duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve pasi: “[...] *Prokurori nuk i kishte kryer të gjitha veprimet e duhura të nevojshme dhe të domosdoshme, ai ka lënë përgjysmë hetimin e nisur pa asnjë justifikim e në rihetimin e çështjes nga Prokuroria duhet të kryhen disa veprime procedurale*³⁹”.
- iii. Pas regjistrimit të procedimit penal me nr. ***, në rihetim nga subjekti i rivlerësimit u zbatuan detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit⁴⁰ dhe në përfundim vendosi pushimin e procedimit penal nr. ***, duke i kërkuar gjykatës pushimin e çështjes, kjo e fundit me vendimin nr. *** akti, datë 27.11.2018 vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal duke arsyetuar se: “[...] *edhe sipas deklarimeve në prokurori, në zbatim të detyrave të lëna, rrethanat e specifikuar në hetimin e mëparshëm nuk ndryshojnë thelbin apo përmbajtjen e asnjë rrethane për të konkluduar ndryshe*”. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim denoncuesja në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 14.5.2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga shqyrtimi në faqen *online* të Gjykatës së Lartë evidentohet se vendimi është ankimuar dhe regjistruar me nr. ***, datë 16.9.2019.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

65. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është shprehur si vijon:
 - i. *“Fillimisht dua të sqaroj se vendimet e mosfillimit të procedimit penal në lidhje me një material kallëzues të regjistruar në prokurori, merren duke u bazuar në ligjin procedural penal (nenet 290 dhe 291), si dhe është rregulluar në vazhdimësi nga udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe, konkretisht, udhëzim nr. 241, datë 21.11.2005, ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 24.10.2006 dhe udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012. Në këto udhëzime shprehet qartë se: Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit vendos*

³⁷ Detyra të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në kryerjen e rihetimit nga Prokuroria: (i) të pyetet kallëzuesja E. C. rreth faktit për të cilin ka bërë kallëzim; (ii) të bëhet ballafaqimi i kërkuësës E. C. me të kallëzuarin Xh. B.; (iii) të administrohen bisedat nëpërmjet rrjeteve sociale dhe sms-ve të bëra ndërmjet tyre; (iv) organi i Prokurorisë të kryejë veprime të tjera të nevojshme.

³⁸ Vërehet se në ankimin e firmosur dhe të depozituar në Gjykatën e Apelit Tiranë, nga subjekti i rivlerësimit, viti i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është 2016, kur rezultoi në fakt viti 2018.

³⁹ Detyra të lëna nga Gjykata e Apelit: (i) të bëhet ballafaqimi ndërmjet denoncuesës dhe të kallëzuarit Xh. B.; (ii) duhet të administrohen bisedat në rrjetet sociale dhe sms dhe pas verifikimit dhe kryerjes së detyrave të lëna nga organi i Prokurorisë, të vlerësohet nëse ka apo jo elementë të ndonjë vepre penale.

⁴⁰ Detyrat e zbatuara nga subjekti i rivlerësimit në rihetim: së pari (i) janë thirrur të dyja palët për ballafaqim për të sqaruar dhe konkretizuar pozicionin e tyre në lidhje me faktin penal të kallëzuar; (ii) në kuadër të veprimeve hetimore dhe detyrave të lëna kanë administruar bisedat e rrjeteve sociale, foto të thirrjeve telefonike etj., të cilat janë administruar dhe së dyti: (iii) ka analizuar elementët e ekzistencës së veprës penale.

mosfillimin e procedimit [...]. Gjatë kësaj periudhe mund të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementëve të figurës së veprës penale, prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe prokurori nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

- ii. Në të tri rastet që më është kërkuar të jap shpjegime janë zbatuar me përpikmëri kërkesat ligjore të neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale dhe, po ashtu, edhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm. Në të tria këto raste janë kryer vetëm veprime verifikuese të materialit kallëzues të regjistruar në Prokurori dhe jo hetime të mirëfillta, pasi kam gjykuar se nuk përmbusheshin kushtet ligjore për regjistrimin e procedimit penal. Edhe pas prishjes së vendimeve të mosfillimit të procedimit penal, në të tria këto raste të denoncuar, në përfundim, vendimmarrja përputhej me zgjidhjen ligjore dhe arsyetimin tim që në momentin e vendimit të mosfillimit. Prishja e këtyre vendimeve të mosfillimit të procedimeve penale dhe urdhërimi i veprimeve hetimore vetëm sa ka rritur koston e burimeve njerëzore dhe shpenzimeve procedurale të mbuluara nga shteti.
- iii. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të shtetases E.C., ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, në datën 27.9.2016, unë, si prokuror i ngarkuar për trajtimin e këtij kallëzimi, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. *** duke argumentuar që fakti penal i kallëzuar është një fakt juridiko-civil dhe mund të zgjidhet nga palët në Gjykatën Civile. Nëpërmjet vendimit të Prokurorisë, kallëzuesja orientohet të ndjekë rrugë të tjera procedurale dhe ligjore në Gjykatën Civile. Është pikërisht ky orientim i bërë nëpërmjet vendimit të mosfillimit të procedimit penal, që ka bërë që kallëzuesja t'i drejtohet Gjykatës Civile dhe të zgjidhë pretendimet e saj në lidhje me shtetasin Xh.B. Vendimi i prokurorit është ankuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, më pas, në Gjykatën e Apelit Tiranë, të cilat kanë vendosur për fillimin e hetimeve. Pas vendimit të Gjykatës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2018.
- iv. Pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata (një ballafaqim mes palëve dhe administrim i printimeve të kallëzueses nga rrjetet sociale), në datën 16.11.2018, i kërkoj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pushimin e procedimit penal nr. *** me të njëjtin argument të përdorur që në arsyetimin e mosfillimit të procedimit penal. Ankuesja ka qenë në gjykimin e kësaj kërkesë duke paraqitur edhe objeksionet e saj kundër vendimit të Prokurorisë. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.2.2019 vendosi miratimin e vendimit të prokurorit, për pushimin e procedimit penal nr. 6070/2018. Po ashtu, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. ***, datë 14.5.2019 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pushimin e procedimit.
- v. Veprimet e mia si prokuror, në rastin konkret i konsideroj të drejta dhe në zbatim të ligjit material, ligjit procedural penal dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Këto vendime janë shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Gjykata e Apelit Tiranë, të cilat kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të njëjtin argument të përdorur që në arsyetimin e mosfillimit të procedimit penal, çka tregon se veprimet e urdhëruara nga gjykata (një ballafaqim mes palëve dhe

*administrim i printimeve të kallëzueses nga rrjetet sociale) për prishjen e vendimit të mosfillimit nr. *** nuk kanë ndikuar në një qëndrim apo zgjidhje tjetër ligjore për çështjen në fjalë”.*

2. Denoncim me nr. * prot., datë 18.2.2019, i shtetasit E. S.**

66. Denoncuesi E. S. është shprehur se subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 14.10.2015. Komisioni, me qëllim kryerjen e një vlerësimi mbi dokumentet përkatëse, iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2020, përcolli dokumentacionin e kërkuar, nga ku rezultoi se:

i. Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar kallëzimin nr. ***, me objekt falsifikimin e dokumenteve, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe në përfundim të shqyrtimit të materialit kallëzues ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, datë 23.7.2015 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këtë çështje “... pasi nuk janë kryer veprime të plota dhe të gjithanshme hetimore⁴¹ për verifikimin e kallëzimit të bërë nga shtetasi E. S.”. Vendimi i Gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë, 22.7.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës, duke lënë edhe disa detyra konkrete për hetimin e çështjes në fjalë.

ii. Në datën 17.10.2016, pranë Prokurorisë së mësipërme është regjistruar procedimi penal nr. ***, lidhur me të cilin, në vijim janë kryer nga subjekti i rivlerësimit disa veprime hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Apelit Tiranë⁴². Në përfundim, bazuar në nenin 290, germat “ç” dhe “e” dhe neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, ai ka vendosur mosfillimin⁴³ e procedimit me argumentimin se: “... Jo vetëm për shkakun se nuk konstatohen elementë të veprës penale të kallëzuar, por edhe për faktin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur me vendimin e datës 31.12.2014, i cili ka mbetur në fuqi edhe pas ankimit në Gjykatë”⁴⁴.

iii. Ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit është paraqitur një ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së

⁴¹ Detyrat e lëna nga Gjykata e Tiranës: (i) të marrë në pyetje shtetasit në cilësinë e personave që kishin dijeni shtetasin A. L.: (ii) të kryejë veprimet e nevojshme për marrjen e akteve të ndryshme, lidhur me rrethanat e aksidentit në punë të datës 19.7.2014 të dala gjatë hetimit të procedimit penal nr. ***, datë 11.9.2014, si dhe të krahasohen ato rrethana dhe shkaqet e aksidentit në punë, të përshkruara në procesverbalin e aksidentit në punë nr. ***; (iii) në rihetimin e kësaj çështjeje duhet të kërkohet pranë ISHPSH-së dosja e hetimit lidhur me aksidentin e ndodhur, duke arritur kështu në konkluzion të drejtë lidhur me kallëzimin e shtetasit E. S.

⁴² Veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në rihetimin e procedimit penal: (i) është pyetur shtetasi E. S., inspektor i DRT-së në Inspektoratin e Punës, i cili ka dhënë dëshminë e tij; (ii) janë administruar të gjitha aktet procedurale të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014 në lidhje me hetimin e ngjarjes në fjalë; si dhe (iii) është administruar vendimi nr. *** i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi nr. *** i Gjykatës së Apelit Tiranë, nga ku vendimi i Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. *** është quajtur i drejtë dhe i arsyetuar.

⁴³ “pushimin” do të ishte ndoshta përkufizimi më i saktë, por kështu rezultoi e shkruar në aktet përkatëse – ndoshta është një lapsus.

⁴⁴ Nga denoncimi evidentohet se ndaj vendimit të prokurorit është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, vendosi rrëzimin e kërkesës, vendim ky që u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** akti.

akimuesit. Ky vendim gjithashtu është lënë në fuqi edhe pasi është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** akti.

- iv. Gjithashtu, nëpërmjet një verifikimi/aksesimi *online* të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, është konstatuar se denoncuesi E. S. ka paraqitur rekurs në datën 18.1.2019, duke kërkuar ndryshimet e vendimeve të gjykatave që kanë miratuar vendimin e prokurorisë së datës 17.10.2016, duke kërkuar prishjen e tyre. Kjo çështje mban nr. *** dhe aktualisht gjendet në fazën e studimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

67. Z. Adriano Dyrmishi, edhe lidhur me këtë çështje, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ ka paraqitur prapësimet, si vijojnë:

- i. *“Sqaroj se në datën 14.1.2015, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar kallëzimi penal nr. 495, me kallëzues shtetasin E. S. për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.*
- ii. *Në datën 2.2.2015, unë si prokuror i ngarkuar për trajtimin e këtij kallëzimi kam vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. *** me argumentin se nuk konstatohen elementë të veprës penale dhe parimi i gjësë së gjykuar në një procedim tjetër. Ky vendim është ankimuar në gjykatë nga ana e kallëzuesit, e cila me vendimin nr. *** akti, datë 23.7.2015, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këtë çështje. Edhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 22.7.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës, duke lënë edhe disa detyra konkrete në rihetimin e çështjes.*
- iii. *Pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore, në datën 17.10.2016 është vendosur sërish mosfillimi i procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***. Ky vendim është ankimuar në gjykatë nga ana e kallëzuesit. Në përfundim të debatit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesës penalo-administrative nr. *** akti, datë 25.11.2016, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Gjykata e Apelit Tiranë, pas ankimit të kallëzuesit, me vendimin nr. ***, datë 17.10.2018 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- iv. *Veprimet e mia si prokuror, për sa i përket vendimmarrjes në rastin konkret, i konsideroj të drejta dhe në zbatim të ligjit material, ligjit procedural penal dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Këto veprime janë shqyrtuar dhe janë gjetur të drejta nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me të njëjtin argument të përdorur që në arsyetimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, çka tregon se veprimet e urdhëruara nga gjykata, për prishjen e vendimit të mosfillimit nr. ***, nuk kanë ndikuar në një qëndrim apo zgjidhje tjetër ligjore për çështjen në fjalë.*
- v. *Vlen të theksoj se veprimet hetimore verifikuese, në kuadër të këtij kallëzimi penal dhe po ashtu edhe vendimmarrja përfundimtare kanë qenë të lidhura ngushtë me hetimin e procedimit penal nr. ***. Ky procedim penal është pushuar nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi i pushimit ka mbetur në fuqi në të dyja shkallët e gjykimit (formë e prerë), pas ankimit të bërë nga ana e shtetasit E. S.”*

3. Denoncimi nr. * prot., datë 7.9.2018, i shtetasit F. K.⁴⁵**

68. Nëpërmjet këtij denoncimi, shtetasi F. K. shprehet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime, lidhur me kallëzimin nr. ***, të depozituar prej tij, qoftë edhe sipërfaqësore të provave dhe fakteve, duke pretenduar se në shkëmbim të këtij mosveprimi prokurori në fjalë ka marrë shumën prej 6.000 euro. Denoncuesi nuk ka depozituar apo përshkruar ndonjë provë apo fakt lidhur me dinamikën, apo vërtetësinë/burimin e informacionit për sa aludon. Komisioni, për të kryer një vlerësim të këtij rasti në këndvështrimin profesional, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe dosjes hetimore përkatëse. Kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2020, vuri në dispozicion materialin dhe nga shqyrtimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr. 5064/2018, është konstatuar:

- i. Në datën 14.6.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. ***. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 999 akti, datë 10.10.2016 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit në fjalë, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e një sërë detyrash hetimore⁴⁶. Më tej, pas ankimit edhe të këtij vendimi të Gjykatës, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.5.2018 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, Prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 27.6.2018 dhe nga subjekti i rivlerësimit janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Apelit⁴⁷.
- ii. Në përfundim të hetimeve në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se pretendimet e ngritura me kallëzimin e sipërpërmendur janë thelbi i një konflikti juridiko-civil, i cili mund të zgjidhet nga palët në rrugë gjyqësore, sipas dispozitave të Kodit Civil dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale duke njoftuar të pandehurin/denoncuesin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

69. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me këtë denoncim, ka shprehur si vijon:

- i. *“Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Flamur Kalivaçi, është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2016 për veprën penale ‘falsifikimi i dokumenteve’, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.*
- ii. *Në datën 14.6.2016, unë, si prokuror i ngarkuar për trajtimin e këtij kallëzimi kam vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, me arsyetimin se nuk jemi përpara elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal apo ndonjë veprë tjetër penale. Pretendimet e ngritura në kallëzim, lidhur me shkrimin e gjeneraliteteve (emër mbiemër) të shtetasit F. K. në mbledhjen e asamblesë së shoqërisë BBF pa nënshkrimin (firmë) e tij, nuk*

⁴⁵ Ky denoncues i është drejtuar edhe Prokurorisë së Përgjithshme, referojuni - ankesa nr. 4, të marrë në shqyrtim në kapitull.

⁴⁶ Detyrat e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë si thirrja e dëshmitarëve dhe administrimi i dokumentacionit.

⁴⁷ Janë thirrur dhe pyetur shtetasit B. K, F. K., F. S., të cilët kanë dhënë deklarinë e tyre, kanë dhënë shpjegimet lidhur me shoqërinë aksionere, si dhe kanë administruar disa dokumente në mbështetje të deklarimeve të tyre, si detyra të lëna dhe të urdhëruara nga Gjykata.

*përmbush anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Me vendimin nr. *** akti, datë 10.10.2016, Gjykata ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit në lidhje me kallëzimin nr. ***, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e një sërë detyrash hetimore të përcaktuara në këtë vendim. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.5.2018 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

- iii. *Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 27.6.2018 dhe nga ana ime si prokuror janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata. Pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore, i jam drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 27.6.2018 me të njëjtin argument të përdorur në vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj., datë 3.12.2018 vendosi miratimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***.*
- iv. *Veprimet e mia si prokuror, për sa i përket vendimmarrjes në rastin konkret, i konsideroj të drejta dhe në zbatim të ligjit material, ligjit procedural penal dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Këto veprime janë shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila këtë vendimmarrje e ka gjetur të drejtë, të arsyetuar dhe në interpretim të saktë të ligjit me të njëjtin argument të përdorur që në arsyetimin e mosfillimit të procedimit penal, çka tregon se veprimet e urdhëruara nga gjykata, për prishjen e vendimit të mosfillimit nr. *** nuk kanë ndikuar në një qëndrim apo zgjidhje tjetër ligjore për çështjen në fjalë”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

- 70. Nisur nga ngjashmëria e dinamikës së tri çështjeve të shqyrtuara më lart dhe nga objekti i përafërt i tri denoncimeve përkatëse (për sa i përket rrethanave që hyjnë në kompetencën e Komisionit), veç sa është përshkruar më sipër, lidhur me shqyrtimin dhe me analizimin e materialeve të administruara, nga një vlerësim i përbashkët i tyre dhe duke mbajtur në vëmendje edhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit, pas fazës fillestare verifikuese mbi përmbajtjen e kallëzmeve, ka zgjedhur të shprehet me vendime mosfillimi, duke mos e konsideruar të nevojshme kryerjen e hetimeve të mirëfillta, nëpërmjet regjistrimit *propedeutico* të procedimeve penale; (ii) Gjykatat e shprehura mbi këto vendime mosfillimi i kanë gjetur këto të fundit të pabazuara, dhe kanë urdhëruar kryerjen e veprimeve konkrete hetimore; (iii) subjekti i rivlerësimit, pas kryerjes së hetimeve (të urdhëruara), ka konkluduar për pushimin e procedimeve në fjalë, për sa kohë nuk janë gjetur elementë të ekzistencës/kryerjes së veprave penale të pretenduara nga kallëzimet; (iv) qëndrimet e subjektit lidhur me pushimin e këtyre procedimeve janë miratuar dhe janë lënë në fuqi edhe nga gjykatat, të cilat i kanë shqyrtuar më tej çështjet në fjalë.
- 71. Lidhur dhe, për rrjedhojë, të konstatimeve të sipërpërshtuara, trupi gjykues, nga njëra anë vlerëson se është përballë një qasjeje hetimore të subjektit, në disa raste disi të ngurtë apo sipërfaqësore – për sa kohë fillimisht ai nuk ka kryer hetime të plota, por nga ana tjetër, çmon se fakti që edhe pasi janë kryer të gjitha hetimet e urdhëruara, rezultati final nuk ka ndryshuar (pasi në asnjë rast nuk janë gjetur elementë për të çuar të dyshuarit për gjykim), e zbeh peshën e mosveprimit fillestar. Gjithashtu, fakti që vendimet e pushimit të paraqitura/kërkuara nga subjekti, janë gjetur të drejta edhe nga gjykatat shqyrtuese, e

përfundimtar faktin që mungesa e hetimit fillestar mund të kishte ardhur si pasojë e ndonjë paaftësie vlerësuese të fakteve nga subjekti, apo, për më tepër (siç aludohej në njërin prej denoncimeve), me qëllim favorizimin e personave/it të dyshuar. Megjithatë, nga këndvështrimi formal mbetet një qasje hetimore e cunguar, ndonëse, me vetëm këto raste, nuk mund të konsiderohet si një *modus operandi* e konsoliduar e subjektit.

72. Në vlerësim të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, nisur nga gjendja faktikoligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart nga Komisioni, duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me standardin sasior e cilësor të vlerësimit të këtij kriteri – të shpehur nëpërmjet vendimit nr. 28/2020 (JR) – trupi gjykues çmon se nuk kanë rezultuar problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda etiko-profesionale, për të vënë në diskutim kualifikimin profesional të këtij subjekti.
73. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore që përcaktojnë pragun e kualifikimit profesional.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Adriano Dyrmishi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.12.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Relator

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Anisa Duka

Sekretare gjyqësore